



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljubijanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr.42/23

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje prej: Agon Ramadani - Kryetar, Kimete Gashi- Anëtare dhe Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Rojet e Nderit" sh.p.k me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës", me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datën 23. 05. 2023, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Rojet e Nderit" me seli në Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit më 17.01.2023 për aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës", me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Kuvendi i Komunës së Prishtinës, kurse Vendimi i cituar si më sipër i AK Anullohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP-së, për gjitha veprimet e ndërmarra me këtë aktivitet të prokurimit, i precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

III. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimin të ankesës, kurse ankuesi ka të drejtë që, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të parashtrroj kërkesë për kthimin e mjeteve, në të

kundërtën të njëjtat konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.05.2019, AK - Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1. Ndërsa me 06.01.2023 AK - Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me datë 10.01.2023 Operatori Ekonomik LLC “Rojet e Nderit” sh.p.k - Prishtinë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK - Kuvendi Komunës së Prishtinës. Me datë 13.01.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatori Ekonomik LLC “Rojet e Nderit” sh.p.k - Prishtinë dhe ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të publikuar me datë 06.01.2023. Si dhe AK të vazhdoj me vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit “Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1 sipas njoftimit mbi vendimin për anulim te AK të datës 06.01.2023.

Me datën 17.01.2023 Operatori ekonomik “Rojet e Nderit”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 42/23, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Lloji i kontratës: shërbime, Vlera e parashikuar e kontratës: 2,100,000.00 €.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë në OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu edhe nenit 108/A të ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie në kompetencat e tij në kuptim të nenit 105 të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 01.02.2023, eksperti shqyrtues ka

dorëzuar Raportin e vlerësimit i cili është pranuar nga të dy palët, me ç'rast AK pajtohet me mendimin e ekspertit ndërsa OE ankues nuk pajtohet me mendimin e ekspertit.

-Mendimi i ekspertit shqyrtues-

Duke pasur parasysh ecurinë e aktivitetit të prokurimit, Eksperti Shqyrtues lidhur me ankesën e parashtruar me nr.42/23, nuk mund të jap ndonjë vlerësim apo rekomandim pasi që për këtë lëndë janë 6 vendime të Paneleve Shqyrtuese dhe 6 vendime të Autoritetit Kontraktues.

-Seanca dëgjimore-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca degjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtruesat e tyre, ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues-

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklaramentit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, sqaron se deri tek vendim-marrja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi është arritur duke konsideruar veprimet e AK të ndërmarra në rastin konkret, anulimi mbi bazën e tejkallimit të vlerës së parashikuar duke aplikuar nenin 62, PSH ka arritur në konstatimin se arsytimi i tillë nuk ka qenë argumentues dhe i mbështetur në fakte të mjaftueshme të cilat dëshmojnë se aplikimi i nenit 62 (Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit) është arritur duke aplikuar paragrafin 2, pikën 1, i cili përcakton se AK-të mund ta përfundojnë i aktivitetin e prokurimit nëse: *të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit*, gjithashtu PSH ka konsideruar bazën argumentuese të OE ankues i cili në ankesën e tij ka paraqitur poashtu sqarimin e kërkuar nga AK para dorëzimit të ofertave, të datës 03.06.2019 me të cilin janë drejtuar AK-së se pas analizës së kërkesave të DT, në bazë të cilave arrihet fondi i përgjithshëm i 1.423.008 orëve pune për periudhën 36 mujore dhe përderisa kërkesa është që paga mujore bruto të jetë së paku 250 euro në muaj, AK është përgjigjur si në vijim: *Lidhur me pyetjen tuaj referohuni dosjes së tenderit, saktësisht Aneksi 1 tek specifikimet teknike që do të thotë se Kontrata Kornizë mund të shtohet edhe për 30 % e që arrinë vleren 2.730.000,00.* ", poashtu PSH ka konsideruar faktin që lidhur me aktivitetin e njëjtë të prokurimit AK përgjatë procedurave të mëhershme veçse ka rekomanduar OE të tjerë e poashtu OE ankues, andaj baza arsyetuese lidhur me aplikimin e nenit 62 konsiderohet si e mangët dhe jo bindëse duke konsideruar të gjitha rrethanat dhe veprimet e

zhvilluara në aktivitetin përkatës.

Bazuar në të gjitha që u thanë si më sipër, PSH ka konstatuar se aktiviteti i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim për faktin parimor se faktet kundërthënëse të sipërcituara si dhe mungesa e dëshmiave adekuate që vërtetojnë gjendjen e paraqitur nga AK kanë krijuar vështirësi në aspektin e vendim-marrjes nga ana e panelit shqyrtues, andaj në rast të aplikimit të nenit 62 nga ana e AK kërkohet që të ndërmarrë masa sipas legjislacionit në fuqi i cili përcakton se lidhur me çështjen e njëjtë duhet të paraqiten dëshmi se kemi të bëjmë me tejkalim buxheti, konkretisht të paraqiten konfirmimet nga dikasteret përgjegjëse si dhe/apo ndryshimet eventuale në planet buxhetore financiare, planet e prokurimit e poashtu dëshmi tjera relevante që do të mbështesnin bazën arsyetuese lidhur me faktin e tillë.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës së parë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës

1x1 OE "Rojet e Nderit"- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.